



## Programi për Angazhim Qytetar Grante për Partneritet

Lëshuar nga: PROGRAMI PËR ANGAZHIM QYTETAR  
Thirrje për aplikim për “Grante për Partneritet”  
Subjekti: për të kontribuar në rritjen e bashkëpunimit  
ndërsektorial

Qëllimi: Programi për Angazhim Qytetar (CEA) i financuar nga misioni i USAID-it në Kosovë ka hapur thirrjen për aplikime për të mbështetur partneritetet ndërmjet Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) dhe sektorit privat. Këto partneritete do të punojnë në iniciativa të përbashkëta që adresojnë shqetësimet e komunitetit dhe promovojnë bashkëpunimin ndërsektorial, me synimin për të kontribuar në rritje të besimit social dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për mbështetjen financiare dhe jofinanciare të shoqërisë civile.

Kriteret kualifikuese: për t’u konsideruar për vlerësim aplikantët duhet të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese të paraqitura më poshtë me rastin e dorëzimit të aplikacionit.

- Partneritetet duhet të përbëhen nga të paktën një OJQ dhe një nga sektori privat (p.sh. biznes, media). Partneritetet me sektorin privat që vepron në diasporë do të konsiderohen me përparësi.
- Aplikanti dhe zbatuesi kryesor duhet të jenë OJQ aktive të regjistruara në Kosovë.
- Aplikanti duhet të dëshmojë se ka një histori të një sistemi të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe se përmbushë kërkesat organizative të kujdesit të duhur (organizational due diligence requirements).
- Intervenimi i propozuar duhet të kontribuoj në qëllimin e përgjithshëm të CEA-së dhe fokusohet në angazhimin e komunitetit, besimin social dhe diversifikimin e burimeve për zgjerim të bashkëpunimit ndërsektorial, të orientuar drejt zgjidhjeve për t’u përgjigjur më mirë interesave të komunitetit dhe kultivimin e një kulture të dhënies përmes filantropisë, mbledhjes së fondeve dhe vullnetarizmit në Kosovë.
- Intervenimi i propozuar duhet të tregojë se është zhvilluar bazuar në të një vlerësimi të nevojave në partneritet me palët e interesuara përkatëse.
- Degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë si dhe klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore apo organizatat fetare që janë të regjistruara si OJQ, nuk janë synimi i kësaj thirrje.
- Buxheti i thirrjes është i limituar në €7,300 dhe nuk mund të tejkalojë 80% të totalit të buxhetit të projektit. Buxheti total i propozuar duhet të përmbajë një minimum prej 20% bashkëfinancim nga sektori privat ose nga komuniteti. Ju lutem t’i referoheni shembujve të paraqitura më poshtë, në pjesën ‘Financimi’.
- Bashkëfinancimi nuk duhet të jetë nga entitetet e ndërlidhura me organizatën aplikuese.
- Përfaqësuesi ligjor i OJQ-së aplikuese nuk duhet të shërbejë si partner i propozuar në projekt, si dhe nuk duhet të ketë ndonjë detyrim ligjor apo lidhje formale me organizatën partnere që aplikon.
- Aplikanti nuk duhet të jetë Person i Ekspozuar Politikisht.



- Aplikacionet mund të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

**Financimi:** Grantet për Partneritet duhet të bashkëfinancohen përmes iniciativave të përbashkëta ndërmjet shoqërisë civile dhe sektorëve të tjerë. Pjesa e bashkë-financuar duhet të përfaqësojë të paktën 20% të buxhetit total. Nuk ka kufizim për buxhetin total, megjithatë financimi nga ky grant është i kufizuar në 7,300 € dhe nuk mund të kalojë 80% të buxhetit total. Çdo kërkesë e mbetur buxhetore mbi kufirin prej 7,300 €, duhet të vijë nga burime të tjera. Kontributet jo-financiare (in-kind) janë të mirëseardhura mirëpo nuk konsiderohen si bashkëfinancim.

**Shembull 1:** Nëse buxheti total i projektit është 30,000 euro, mund të kërkohet deri në 7,300 euro nga granti, që është maksimumi i mundshëm, dhe një minimum prej 6,000 eurosh nga buxheti i mbetur (20% e 30,000 eurove) duhet të sigurohet përmes bashkëfinancimit nga partnerët.

**Shembull 2:** Për një projekt me një buxhet total prej 8,000 euro, mund të kërkohet deri në 6,400 euro nga granti, pasi kjo nuk tejkalon 80% të buxhetit total të projektit të propozuar. Poashtu, duhet siguruar një minimum prej 1,600 euro (20% e 8000 euro) përmes partneriteteve bashkëfinancuese.

**Informatë:** Për t'u konsideruar për këtë mundësi financimi, aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikacionet në [ceainfo@kcsfoundation.org](mailto:ceainfo@kcsfoundation.org).

*Pyetjet në lidhje me dokumentet për aplikim mund të adresohen në [ceainfo@kcsfoundation.org](mailto:ceainfo@kcsfoundation.org).*

*Përgjigjet ndaj të gjitha pyetjeve të pranuar do të publikohen në seksionin "Apliko për grante" në uebfaqe të KCSF-së*

## Shtojca 1:

### INFORMATA PËR PROGRAMIN PËR ANGAZHIM QYTETAR

Programi për Angazhim Qytetar (CEA) në Kosovë është iniciativë pesë vjeçare që zbatohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Kjo iniciativë është përkushtim për të kultivuar një kulturë të aktivizmit që e bën jetën nëpër lagjet dhe qytetet tona më të mirë, më të dashur dhe më kuptimplotë. Kjo nismë e imagjiron një të ardhme të ndërtuar në themelet e një shoqërie civile, e cila përmes aktivizmit të guximshëm, përfaqësimit nga poshtë-lart, bashkëpunimit të gjithanshëm, veprimit profesional, transparencës në të gjitha hallkat e jetës publike dhe institucionale dhe përdorimit ndryshe të burimeve sjell ndryshim rrënjësor në komunitetet tona. Po kështu, kjo nismë e synon një ndjesi të rigjetur të solidaritetit ndaj njëri-tjetrit.

Duke ndërtuar tutje mbi dijen dhe përvojën e fuqishme të zërave më të shquar dhe të udhëheqësve të fushave të mbështetjes profesionale të shoqërisë civile dhe bashkëpunimin institucional, Programi për Angazhim Qytetar është një përkushtim serioz për të shtuar, demokratizuar dhe për të mbrojtur fuqinë që komunitetet tona kanë për të sjellur ndryshim dhe për të përparuar. Përmes përpjekjeve për koordinim të qëndrueshëm, ndërveprim të mirëfilltë dhe përmes përmirësimit të kapaciteteve të atyre që janë të përfshirë në aktivizëm çdo ditë, Programi për Angazhim Qytetar do të çojë përpara një

numër të madh veprimesh, që mbështeten në këto tri shtylla kryesore: komuniteti, besimi dhe mobilizimi i burimeve.

#### **Fushat e fokusit:**

1. Të nxitet aktivizmi i komunitetit, të forcohen lidhjet e shoqërisë civile me komunitetin dhe të rritet kërkesa për llogaridhënie. Intervenimi synon të kombinojë aktivizmin e fortë të udhëhequr nga qytetarët dhe investimet si katalizator i fuqishëm për ndryshim.
2. Krijimi i partneriteteve ndërsektoriale dhe rritja e besimit ndërmjet OShC-ve, qytetarëve, sektorit privat dhe institucioneve publike. Intervenimi synon të ndërtojë bashkëpunim ndërsektorial nga shumë sektorë, për të punuar së bashku në zgjidhjet e problemeve të identifikuara nga qytetarët dhe duke njohur rolin e mundshëm të bizneseve në promovimin e përpjekjeve filantropike për të mirën publike.
3. Të shfrytëzohen kapacitetet e OShC-ve dhe të mundësohet mjedis i favorshëm për të mobilizuar burimet alternative vendase dhe të diasporës. Intervenimi synon të rrisë qasjen në burimet brenda dhe jashtë vendit, pra burimet financiare, njerëzore dhe materiale, për ta lehtësuar sigurimin e mbështetjes së komuniteteve për nevojat e tyre për të krijuar ndryshime.

Shënim: Propozimet e projekteve që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis ose që përfshijnë blerjen e pajisjeve të vogla, instalimeve, mallrave, materialeve bujqësore, etj., do të kërkojnë një vlerësim shtesë përpara se të miratohen.

#### **Shtojca 2:**

##### **INFORMATA TË MËTEJSHME PËR GRANTET PËR PARTNERITET**

###### **i. Qëllimi i financimit**

Kjo mundësi e financimit synon të kontribuojë në përmirësimin e bashkëpunimit ndërsektorial dhe partneritetit ndërmjet shoqërisë civile dhe sektorit privat. Si i tillë, propozimi duhet të jetë në partneritet me të paktën një partner nga sektori privat, përveç OJQ-ve. Numri i përgjithshëm i partnerëve të përfshirë nuk është i kufizuar. Partneritetet me sektorin privat që vepron në diasporë do të konsiderohen me përparësi.

- Krijimin e partneriteteve ndërsektoriale ose
- Avancimin e partneritetit ekzistues ndërsektorial, duke përfshirë partneritetet që rrjedhin nga Forumet e Filantropisë dhe Nismat për Bashkëpunim në Komunitet të Fasilituara nga Programi.

Si e tillë, kjo thirrje ju dedikohet aplikacioneve që angazhojnë sektorë të ndryshëm në punë të përbashkëta, duke mbështetur kështu partneritetet shumësektoriale, në vend të qasjeve të fragmentuara dhe individuale. Për të siguruar partneritet funksional, partnerët e propozuar zbatues duhet të jenë shumë të përfshirë në të gjitha fazat duke filluar nga identifikimi i intervenimit të propozuar, hartimi dhe zbatimi i tij. Ky proces duhet të paraqitet qartë në aplikacion.



## ii. Shuma e grantit dhe ndarja e kostos

Shuma maksimale e grantit që mbështetet nga kjo thirrje është 7,300 euro. Pjesa e mbetur (minimumi 20% e buxhetit total) duhet të bashkëfinancohet nga sektori privat ose nga komuniteti. Kontributet jo-financiare (in-kind) janë të mirëseardhura por nuk do të konsiderohen si bashkëfinancim.

Fondet duhet të përdoren vetëm për shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetet e propozuara të grantit. Aplikantët mbajnë përgjegjësi të plotë për korrektësinë dhe saktësinë e buxhetit të propozuar duke përfshirë gabimet aritmetike, pasaktësitë, kostot joreale dhe kostot e papranueshme.

## iii. Numri i aplikacioneve

Aplikantët kryesor mund të dorëzojnë dhe të përfshihen në vetëm një aplikacion.

## iv. Afati kohor

Zbatimi i projektit nuk duhet të tejkalojë periudhën kohore prej 12 muaj.

## v. Përfituesit e synuar

Përfituesit përfundimtarë të intervenimit të propozuar duhet të jenë qytetarë të komunitetit ku do të zbatohet intervenimi ose të Kosovës në përgjithësi. Për përfituesit kryesorë/grupet e synuara, duhet të synohet pjesëmarrja e barabartë gjinore. Kurdoherë që është e mundur, qasje e ngjashme duhet ndjekur edhe për përfshirjen e grupeve të tjera të nënpërfaqësuar dhe grupeve të marginalizuara (komunitetet jo-shumicë, gratë, të rinjtë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, LGBTI, etj.).

## Shtojca 3:

### INFORMATAT MBI KUALIFIKIMIN

#### i. Aplikantët e kualifikuar

##### *Organizatat joqeveritare*

Pavarësisht statusit të tyre ligjor, jo të gjitha OJQ-të kanë të drejtë të aplikojnë për këtë thirrje. Konkretisht, degët e OJQ-ve të huaja dhe ato ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë si dhe klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore apo organizatat fetare që janë të regjistruara si OJQ nuk janë objektiv i kësaj thirrje.

#### ii. Aktivitetet dhe intervenimet e papranueshme

- Intervenimet që lidhen drejtpërdrejt ose mbështesin partitë politike
- Ndihma emergjente dhe bamirësi
- Investimet Kapitale
- Projekti i përbërë kryesisht nga punë përgatitore dhe/ose studime
- Aktivitetet ndërkufitare

- Aktivitete të llojit të shërbimit si Asistenca Teknike për institucionet publike dhe/ose subjekte të tjera.
- Intervенimet që i nënshtrohen varësisë dhe miratimit në shumë nivele, duke paraqitur kështu rrezik të lartë për arritjen e rezultateve
- Grantet ndaj palëve të treta
- Bursat
- Konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta

### iii. Fondet/kostot e papranueshme

- Tatimin mbi vlerën e shtuar - TVSH
- Blerja e pajisjeve
- Shpenzimet që lidhen me ndërtimin
- Borxhi ose pagesa për humbje
- Detyrimet doganore dhe të importit
- Pagesa e huasë dhe investimit
- Shpenzimet për zhvlerësim të pajisjeve
- Blerja e tokës ose e pronës së paluajtshme
- Tarifat e këmbimit valutor
- Pagesa e shpenzimeve të mbuluara nga donatorë të tjerë
- Kreditë për palët e treta (grante)
- Shpenzimet indirekte (overhead)

### Shtojca 4:

#### PROCESI I APLIKIMIT

Aplikacionet për këtë thirrje do të vlerësohen në dy faza. Në fazën e parë, aplikacionet rishikohen nëse plotësojnë kërkesat teknike. Vetëm aplikacionet që kalojnë me sukses këtë fazë do t'i nënshtrohen vlerësimit të plotë.

#### 1. Përputhshmëria administrative (verifikimi i kritereve formale)

Gjatë kësaj faze, të gjitha aplikacionet vlerësohet nëse janë dorëzuar/respektuar këto në vijim:

- Aplikanti kryesor është OJQ aktive me bazë në Kosovë e angazhuar për qëllime jofitimprurëse (degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë, si dhe klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore ose organizatat fetare që janë të regjistruara si OJQ nuk kanë të drejtë të aplikojnë).
- Aplikuesi kryesor është gjithashtu zbatuesi kryesor që merr përgjegjësinë e plotë për zbatimin dhe menaxhimin e grantit.
- Aplikuesi kryesor nuk është Person i Ekspozuar Politikisht (PEP).
- Propozimi duhet të jetë në partneritet me të paktën një partner që nuk është nga sektori i OJQ-ve. Numri i përgjithshëm i partnerëve të përfshirë nuk është i kufizuar. Në rast se një OJQ tjetër propozohet si partner zbatues, atëherë ajo duhet të përmbushë kriterin e parë të pranueshmërisë.
- Intervенimi i propozuar do të zbatohet në Kosovë.

- Për aplikim përdoret formulari i ofruar i aplikacionit dhe buxhetit.
- Buxheti (Shuma maksimale e grantit që mbështetet nga kjo thirrje është 7,300 euro. Pjesa e mbetur (minimumi 20% e buxhetit total) duhet të bashkëfinancohet nga sektori privat ose nga komuniteti.
- Periudha kohore e zbatimit nuk duhet të tejkalojë periudhën prej 12 muaj.
- Të dorëzohen të gjitha dokumentet e kërkuara.
- Të plotësohen kërkesat e paraqitura në formularin e aplikimit.

Aplikacionet që nuk plotësojnë kërkesat specifike, nuk vlerësohen më tej. Rezultatet e kësaj faze të vlerësimit do t'i komunikohen secilit aplikant me shkrim.

## 2. Vlerësimi i plotë

Aplikacionet që kalojnë fazën e përputhshmërisë administrative kualifikohen për vlerësimin e plotë të bazuar në kriteret e përcaktuara më poshtë. Kjo fazë e vlerësimit do të realizohet nga një ekip i jashtëm i vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit	Pyetjet kryesore të vlerësimit	Pikët
Relevanca me Programin për Angazhim Qytetar	Si kontribuon intervenimi i propozuar në qëllimin e përgjithshëm të Programit?	10
	A kontribuon intervenimi i propozuar në zhvillimin e një bashkëpunimi shumësektorial strategjik, afatgjatë dhe të qëndrueshëm?	
Intervenimi i propozuar	A synon intervenimi i propozuar rastet me interes publik?	10
	A është analizuar mjaftueshëm intervenimi i propozuar? A janë paraqitur qartë nevojat dhe mundësitë?	
Partneriteti	A mbështetë intervenimi i propozuar krijimin e partneriteteve ndërsektoriale ose a kontribuon në avancimin e partneriteteve ekzistuese ndërsektoriale (me fokus në partneritetet ndërmjet shoqërisë civile dhe sektorit privat)?	10
	A janë të përfshirë ngushtë partnerët e propozuar për zbatim në të gjitha fazat duke filluar nga identifikimi i intervenimit të propozuar, projektimi dhe zbatimi i tij, dhe a pritët që bashkëpunimi i propozuar të jetë i suksesshëm?	
Cilësia e aplikimit	A është objektivi i përgjithshëm i intervenimit të propozuar real dhe i paraqitur qartë?	40
	A janë të matshme dhe të arritshme rezultatet e pritura dhe a kontribuojnë ato në arritjen e objektivit të përgjithshëm?	

	<p>A është metodologjia dhe qasja e propozuar e zbatimit e përshtatshme për intervenimin e propozuar?</p> <p>A janë rolet dhe përgjegjësitë e partnerëve të propozuar për zbatim të përcaktuara qartë?</p> <p>A parasheh intervenimi përfshirjen e akterëve përkatës?</p> <p>A janë aktivitetet e propozuara specifike, të arritshme dhe të përshtatshme për intervenimin e propozuar?</p> <p>Kush janë përfituesit kryesor të synuar dhe si do të përfitojnë ata nga ky intervenim?</p> <p>Si do të monitorohet zbatimi i grantit dhe çfarë masa do të aplikohen për të reduktuar sfidat/rreziqet?</p> <p>A është metodologjia e propozuar për vizibilitet dhe përfshirje (outreach) e përshtatshme për intervenimin e propozuar?</p>	
Kapacitetet e zbatimit	<p>A kanë përvojë ekipi i propozuar zbatues lidhur me angazhimin në iniciativë me interes publik; ekspertizë tematike dhe/ose përvojë në çështje të intervenimit?</p> <p>A i posedon ekipi i zbatimit kapacitetet e përshtatshme teknike (infrastrukturë dhe kapacitete tjera teknike) për të siguruar zbatim të drejtë të intervenimit?</p> <p>A ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme për të siguruar menaxhim të duhur administrativ dhe financiar të grantit?</p>	15
Buxheti	<p>A është siguruar minimumi prej 20% i buxhetit të përgjithshëm përmes burimeve tjera? (bashkëfinancimi nga bizneset që veprojnë në diasporë do të konsiderohet përparësi)</p> <p>A është buxheti i propozuar real, me kosto efektive dhe a siguron zbatim cilësor të aktiviteteve?</p>	15

Vlerësimi maksimal për një aplikacion është 100 pikë. Pragu minimal i kalueshmërisë është 70 pikë, si dhe gjysma e pikëve të disponueshme në secilin nga kriteret e gjera të vlerësimit të paraqitura në tabelën e mësipërme (Relevanca me Programin për Angazhim Qytetar, Intervenimi i propozuar, Partneriteti, Cilësia e aplikimit, Kapacitetet e zbatimit dhe Buxheti).




### 3. Dokumentet për aplikim

<b>OJQ-të</b>
Certifikata e regjistrimit e lëshuar nga Departamenti i OJQ-ve në Kosovë
Certifikata e numrit fiskal
Certifikata e regjistrimit të partnerit/-ëve të propozuar të zbatimit
Formulari i aplikimit (në formatin word (.doc)) – sipas modelit të dhënë
Buxheti (në formatin excel (.xls)) – sipas modelit të dhënë
Dëshmi e bashkëfinancimit (p.sh., kontratë, vendim, letërangazhimi, etj (në <i>formatin PDF</i> )).
Deklarata për Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP)



#### 4. Procesi i aplikimit, vlerësimit dhe zbatimit



#### 5. Administrimi i granteve

Grantet e partneritetit do të administrohen në përputhje me 2 CFR 200, 2 CFR 700, në përputhje me kërkesat që zbatohen për grantet e ekzekutuara nga USAID në ADS 303, Grantet dhe Marrëveshjet e Bashkëpunimit për Organizatat Joqeveritare dhe dispozitat standarde të aplikueshme në ADS 303 dhe në Marrëveshjen Bashkëpunuese të Programit për Angazhim Qytetar.

Fondet e USAID-it nuk mund të përdoren për të dhënë fitim sipas instrumenteve të ndihmës. Grantet e partneritetit mund të mbulojnë shpenzime të drejtpërdrejta të arsyeshme, të alokueshme dhe të lejueshme.



Përfituesit e granteve tjera të ofruara në kuadër të CEA-s nuk mund të përfitojnë grante të partneritetit përderisa granti tjetër i fituar është aktiv.

## **6. Dorëzimi i aplikacioneve**

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formën elektronike në [ceainfo@kcsfoundation.org](mailto:ceainfo@kcsfoundation.org). KCSF do t'ia konfirmojë aplikantit pranimin e aplikacionit përmes email.

Nuk merren parasysh aplikacionet e paplota dhe aplikacionet që nuk janë në përputhje me rregullat dhe formatet.

Lëshimi i kësaj thirrje nuk përbën angazhim të dhënies dhe KCSF rezervon të drejtën të mos përzgjedhë asnjë aplikacion të dorëzuar.

### **6.1. Informatat kontaktuese**

Për çdo pyetje lidhur me përgatitjen e dokumenteve për aplikim mund të na kontaktoni **vetëm** në [ceainfo@kcsfoundation.org](mailto:ceainfo@kcsfoundation.org). Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet në lidhje me aplikacionin do të publikohen në seksionin Q&A (pyetjet dhe përgjigjet) të uebsajtit të KCSF-së.

Për të siguruar trajtim të barabartë dhe transparencë të plotë, KCSF nuk mund të jep mendim paraprak mbi pranueshmërinë e aplikantëve, për një operacion ose një aktivitet specifik. Prandaj, ju lutem mos kontaktoni KCSF-në në asnjë formë përveç emailit të dhënë më sipër.

### **6.2. Ankesat**

Aplikantët e pasuksesshëm që besojnë se janë dëmtuar nga ndonjë gabim ose parregullsi gjatë procesit të vlerësimit mund të paraqesin ankesë brenda 3 (tre) ditëve të punës nga dita kur është komunikuar njoftimi.

#### **Shtojca 5: Formularët që duhet bashkëngjitur**

- A. Formulari i Aplikimit për Grant
- B. Formulari i Buxhetit
- C. Deklarata për Personat e Ekspozuar Politikisht